



Nr./Br. 763-2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59.5 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.05.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit

- I. Miratohet memorandumi i Mirëkuptimit, në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Ministrisë së Shkencës dhe Teknologjisë, për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të datës 11 qershor 2017.
- II. Marrëveshja, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.05.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MEMORANDUM MIRËKUPIMI

MES

MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË (MASHT)

DHE

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)

PËR

**BASHKËPUNIM, LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJIT PËR ZGJEDHJET E
PËRGJITHSHME DHE LIGJIT PËR ZGJEDHJET LOKALE NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS**

Palë nënshkruese të Memorandumit

- I. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (në tekstin e mëtejshëm Ministria) dhe
- II. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejshëm Komisioni).

Hyrje

Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) përshkruan kushtet dhe mënyrën e bashkëpunimit lidhur me zbatimin e procedurave zgjedhore të përcaktuara në Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe Ligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Neni 1 Qëllimi

Memorandumi i Mirëkuptimit ka për qëllim bashkëpunimin reciprok në mes të Ministrisë dhe Komisionit për t'i shfrytëzuar objektet shkollore si Qendra të Votimeve (QV), sallave të edukatës fizike për ditën e zgjedhjeve për pranimin e materialit zgjedhor si dhe objekte shkollore për organizimin e trajnimeve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe ofrimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuar që ky entitet të ketë qasje nëpër objekte arsimore ku mbahen zgjedhjet

Neni 2 Përgjegjësitë e MASHT-it

1. Ministria në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Drejtorit Komunale për Arsim në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës do të ndihmojë Komisionin, në për gatitjen e zgjedhjeve në Kosovë duke i inkurajuar drejtorit e shkollave në ofrimin dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për punë, përfshirë:
 - 1.1. Sigurimin e objekteve shkollore si Qendrat e Votimit për organizimin dhe mbajtjen e procesit zgjedhor;
 - 1.2. Ofrimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuar që ky entitet të ketë qasje nëpër objekte arsimore ku mbahen zgjedhjet;
 - 1.3. Angazhimin së bashku me KQZ-në në informimin e akterëve arsimor mbi kushtet e pjesëmarrjes së nxënësve në tubime të organizuara të subjekteve politike, si dhe kërkesat për mos përfshirjen e nxënësve nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë vjeçare) në këto tubime.

1.4. Sigurimin e sallaive të edukates fizike per perdorim per Diten e zgjedhjeve, per pranimin dhe verifikimin e materialit zgjedhor nga QV para se materiali te dërgohet në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) në ato komuna ku ka nevojë.

1.5. Sigurimin e lokaleve për organizimin e trajnimeve të KKV-ve aty ky ka nevojë, nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) pa e penguar procesin mësimor;

1.6. Caktimin e personave kontaktues për zbatimin e këtij memorandumi;

1.7. Ndihma tjera ma arsye të kërkuara nga KQZ-KKZ.

Neni 3 Përgjegjësit e KQZ-së

1. KQZ është e obliguar që objektet e shfrytëzuara si QV, sallat dhe lokalet për trajnim t'i ruaj dhe shfrytëzoj vetëm për organizimin e procesit zgjedhor të paraparë në nenin 2 i këtij Memorandumi;
2. Lejohet shfrytëzimi objekteve shkollore për qëllime të tubimeve publike, vetëm në ato raste, ku nuk pengohet procesin mësimor;
3. KQZ-ja do t'i sigurojë MASHT pasqyrën për Qendrat e votimit, vendndodhjen e tyre;
4. KQZ-ja do të sigurojë që asnjë palë e tretë të mos ketë qasje në objekte shkollore të shfrytëzuara për zgjedhje.
5. Angazhimin së bashku me MASHT-in në informimin e akterëve arsimor mbi kushtet e pjesëmarrjes së nxënësve në tubime të organizuara të subjekteve politike, si dhe kërkesat për mos përfshirjen e nxënësve nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë vjeçare) në këto tubime.
6. KQZ-ja është e obliguar që të caktoj personin kontaktues i cili do t'i koordinoj aktivitetet në mes të KQZ-së dhe MASHT-it;

Neni 4 Dispozitat përfundimtare

1. Për realizimin e objektivave që dalin nga ky memorandum bashkëpunimi palët pajtohen që të caktojnë grupe të veçanta punuese teknike-operative;
2. Konkretizimin e detyrave dhe përgjegjësiave që rrjedhin nga ky memorandum palët pajtohen që ta bëjnë përmes planeve operative pas nënshkrimit të marrëveshjes;

3. Ky memorandum do të aplikohet derisa palët reciprokisht me shkrim, nuk merren vesh ndryshe.
4. Çdo mosmarrëveshje, mospajtim ose shkelje ndërprerje apo pavlefshmëri do të zgjidhet në baza të mirëkuptimit dhe partneritetit.
5. Me nënshkrimin e Memorandumit krijohen obligime të ndërsjella të palëve për realizimit të detyrave të tyre.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky memorandum i mirëkuptimit hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga të dyja palët.

Prishtinë, ____/____/2017

Palët nënshkruese të Memorandumit:

Arsim Bajrami

**Ministër i Ministrisë së Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë**

Valdete Daka

**Kryetare e Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve**